REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 50/17
Date/Datum 21.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL DRAGASH**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **621 2016 031 521**

Sa i përket tenderit për **NDËRTIMIN E UJËSJELLËSIT NË DRAGASH – VAZHDIM I PUNIMEVE**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

KONSORCIUMI PUNA shpk & K-ING shpk

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. 11 Marsi Ortakoll-Prizren , Rr. Veternik II p.n -Prishtinë

(Adresa)

PRIZREN , PRISHTINË — *(Vendi)*

20010 , 10000 — *(Kodi postar)*

044 150 087 , 049 145 749 — *(Numri Telefonit)*

(Numri i Faks-it)

YLBER HALILI dhe HAZIR KUÇI

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nnp_puna@hotmail.com , hazir.kuci@king-ks.com

(Adresa elektronike)

21.02.2017 — *(Data e parashtrimit të ankesës)*

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- ***Njoftimi për anulim 07.02.2017 web faqen e KRPP***
- ***Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët***

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	X				**Jo**	

Në rregull

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po	X				Jo	

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po	X				Jo	

Kërkesën për rishqyrtim e kemi bërë me dt:10.02.2017
Deri më tani nuk kemi marr asnjë vendim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 6 Ekonomiciteti/efikasiteti
- Neni 7-Barazia ne trajtim/Jo diskriminimi
- Neni 59-Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve i LPP
- N|eni 60- Kriteri për dhënie të kontratës
- Neni 62 i LPP- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
- Neni 44 i Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim public-Ndërprerja e procedurave të prokurimit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar anulimi i aktivitetit të prokurimit Ndërtimi i ujësjellësit në Dragash-Vazhdim i punimeve, është bërë në mënyrë kundërligjore në kundërshtim me nenin 62 të ligjit të prokurimit publik pasi arsyeja që është dhënë nuk parashihet në atë nen kjo arsye e anulimit në këtë fazë-pas lëshimit të urdhëresës nga OSHP-ja nuk ka mbështetje ligjore. Arsyeja e anulimit është e pabaz për shkak se kjo arsye parashihet te paragrafi 2.2 i nenit 62 të ligjit të prokurimit publik e ku thuhet se mund të bëhet anulimi i aktivitetit të prokurimit 3 ditë para hapjes së ofertave, ndërsa tani autoriteti kontraktues është në fazen pas vlerësimit që është bërë disa herë dhe tani është lëshuar urdhëres nga institucioni përkatës-OSHP i cili ka vërtetuar shkeljet e autoritetit kontraktues dhe ka lëshuar urdhëresë që të zbatohet vendimi i institucionit kompetent për shqyrtim të ankesave-Organi shqyrtues i prokurimit publik.
Por për çudi edhe OSHP-ja nuk ka vepruar më, pas lëshimit të urdhëresës edhe pse ne ju kemi njoftuar që nuk po zbatohet vendimi dhe mëpastaj urdhëresa e juaj. Pra autoriteti kontraktues ka shkelur nenin që e cekem më lartë në mënyrë flagrante ashtu siç keni bërë shkelje ligjore të njëpasnjëshme në këtë tender duke u munduar me gjdo kusht që të favorizohen kompani të caktuara dhe duke na diskriminuar neve dhe duke shkelur neni 7 të ligjit të prokurimit publik.

Gjithashtu Komuna e Dragashit nuk e ka respektuar dhe e ka shkelur edhe nenin 44.7 dhe 8 të Rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim publik ku ceken arsyet se kur mund të anulohet një aktivitet i prokurimit pas marrjes së ofertave.

Komuna e Dragashit në arsye të anulimit e ka cekur keshtu:
[para hapjes së tenderëve]
Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo
arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit
kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të
prokurimit.

Pra edhe vetë Komuna e Dragashit e ka vendosur këtë arsye tek fjala në kllapa ku shkruan para hapjes së ofertave, e që faktikisht kanë rënë në kundërshtim me vetveten , vetëm për të arritur qëllimin e vet, pasi që nuk po munden të shpallin kompaninë e tyre favorizuese fitues në mënyrë ligjore, atëherë po veprojnë në mënyrë kundërligjore hap pas hapi duke zvarritur procedurën dhe duke e dëmtuar vetë komunitetin e komunës i cili meriton të ketë një jetë më të dinjitetshme, mirëpo që Komuna nuk po ua mundëson atyre këtë për qëllimet e veta të ngushta dhe personale apo grupore të disa individëve që po e mbajnë peng këtë projekt, madje po shkojnë aq larg sa që po pajtohen që të humb në tërësi ky projekt e të mos respektohet ligji dhe të ja japin kontratën firmës e cila i plotëson të gjitha kushtet e kërkuara.

Te njoftimi për anulim në pjesën shtesë është shkruar:
Ky projekt ka qene i parapare te realizohet për vitin 2016 nga mjetet e grantit qeveritar,por pasi qe projekti tre here ka qene ne OSHP për ankese nuk kemi mundur qe deri ne fund te vitit fiskal 2016 te realizojmë tenderimin,mjetet ne fund te vitit janë kthyer prapë ne suficit ne grantin qeveritar, prandaj jemi te obliguar qe te bëjmë njoftimin për anulim te aktivitetit te prokurimit.

Të nderuar kjo rubrika informacione shtesë është e paraparë që të shënohen ndonjë informacionë shtesë në lidhje me arsyen ligjore të anulimit të aktivitetit e jo të jepet arsye në këtë pjesë pasi që arsyen kundërligjore e kanë dhënë më lartë.
Kërkojmë nga ju që të detyroni Komunën e Dragashit që të anulojnë njoftimin për anulim të këtij aktiviteti dhe pastaj të vazhdohet me dhënie të kontratës ashtu siç e keni urdhëruar ju si organ shqyrtues i prokurimit publik në mënyrë që të korrigjohen vendimet e paligjshme të Komunës.
Në këtë rast nuk është respektuar as vendimi i juaj e as urdhëresa, prandaj kërkojmë nga ju që të detyroni komunën e Dragashit që të respektoj urdhëresën tuaj.
Edhe nëse do të humbnin mjetet për këtë projekt (e që nuk është e vërtet kjo) përsëri duhet dhënë përgjegjësi se nga kush u humb ky projekt, e kjo dihet nga zyrtaret e autoritetit kontraktues që kanë zhaguar dhe vonuar me qëllimet e caktuara realizimin e këtij projekti.

Mirëpo nuk janë të vërteta arsyet e eliminimit, pasi që kjo arsye është kundërligjore, ndërsa poashtu kjo komunë ka planifikuar dhe ka ndarë edhe 330 mijë euro për këtë vit, për të realizuar këtë projekt, mirëpo qëllimi i Komunës së Dragashit është që të anulohet fillimisht ky aktivitet i prokurimit

e pastaj të shpallet rishtas që ti përshtaten kërkesat kompanisë së preferuar nga kjo komunë dhe që të na eliminojnë neve si konkurrent serioz dhe që duhet të shpalleshim fitues në këtë rast.

Në nenin 44.7 pika Viii të rregullave dhe të udhëzuesit operativ për prokurim publik thuhet që mund të anulohet aktiviteti i prokurimit nëse urdhërohet nga Organi shqyrtues i prokurimit, ndërsa në këtë rast autoriteti kontraktues është urdhëruar që të zbaton vendimin e OSHP pra ka urdhëresë që të vazhdohet me aktivitetin e prokurimit në fjal e jo të anulohet dhe të ndërprehet, pra Komuna e Dragashit ka vepruar totalisht gabim dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kërkojmë nga ju që të shprehni autoritetin tuaj ta detyroni Komunën e Dragashit që të anuloj këtë njoftim për anulim, që e ka bërë pa arsye ligjore, duke mos respektuar as vendimet e juaja të njëpasnjëshme ku keni konfirmuar parregullsitë e këtij autoriteti kontraktues dhe të zbatohet urdhëresa juaj, pasi që ne jemi duke u dëmtuar shumë. Kërkojë nga ju që të dënoni me gjobë autoritetin kontraktues sipas nenit 131 të Ligjit për prokurim publik për moszbatim të vendimeve dhe urdhrave tuaj dhe njëkohësisht sipas nenit 25.9 i LPP të kërkoni nga KRPP që ti anulohet licenca menaxherit të prokurimit për shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit të prokurimit publik.

Ne jemi të habitur edhe me neglizhencën e OSHP-së, pasi që në raste tjera pas lëshimit të urdhëresës se OSHP janë shqiptuar gjoba autoriteteve tjera dhe janë detyruar ti zbatojnë vendimet e juaja dhe atë vetëm me një njoftim nga kompanitë ankuese, ndërsa ne ju kemi njoftuar për këtë fakt që Komuna e Dragashit nuk ka respektuar vendimin e juaj dhe urdhëresën mirëpo ju nuk keni reaguar fare, prandaj kërkojmë nga ju që edhe ne të trajtohemi barabartë me kompanitë tjera dhe me rastet tjera me qëllim që të përdorni standarde të njëjta. Ne edhe pse ju kemi njoftuar kemi bërë përsëri kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues por që nuk kemi marr përgjigje.
Prandaj ne po dëmtohemi në këtë rast pa arsye ligjor, me arsye banale për anulim, kur dihet që janë mjetet dhe janë ndarë edhe 330 mijë tjera për këtë vit, ndërsa Komuna me qëllim nuk e ka përfunduar vlerësimin me kohë, por ka shkaktuar vonesa për të kaluar fundi i vitit për tu arsyetuar që nuk kemi mjete. Po të analizohet kronoligjikisht ky aktivitet i prokurimit shihen qartë shkeljet e vazhdueshme ligjore nga Kjo Komunë dhe vonesat e paarsyeshme për të zbatuar vendimet e OSHP, mirëpo këtu ju është krijuar një hapësirë edhe nga ana juaj, pasi

që është dashur të monitorohet ky proces pas marrjes së vendimeve tuaja dhe lëshimit të urdhëresave, ndërsa tani është momenti i fundit të tregoni autoritetin tuaj ekzekutiv, pasi që me ligj vendimet e juaja janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme dhe se arsyeja e anulimit nuk ekziston pas hapjes së ofertave, e leje më, pas dy-tri ankesave e për të cilat kemi marr vendime pozitive në favor tonin dhe pas lëshimit të urdhëresës nga ana juaj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e supozuar mua do te me shkaktojnë dëme në aspektin material në vlerën e kontratës si dhe shpenzimet procedurale

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*